



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE



AUDITIMI SOCIAL

KOMUNA E KAÇANIKUT
JANAR, 2025

PËRMBAJTJA

RRETH KLGI.....	7
RRETH MAPL	7
HYRJE.....	8
PROFILI I KOMUNËS	9
KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL	10
PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL.....	11
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	13
HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	15
METODOLOGJIA	15
GJETJET KRYESORE	18
REKOMANDIMET.....	20
KOMENTET E KOMUNËS.....	21
LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL	22



ACADEMY ST

ARTS CENTER

GREAT LAWN

CITY HALL

POLICE DEPARTMENT

MAGISTRATE COURT

FIRE DEPARTMENT

PLAYGROUND

TENNIS COURT

DOG PARK

YOUTH FOOTBALL FIELD

YOUTH FOOTBALL FIELD

DISC GOLF

RRETH KLGI

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) organizatë profesionale i dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë.

KLGI është themeluar në vitin 2008 bazuar në modele ndërkombëtare që kanë për qëllim angazhimin e madh të vendit lidhur me proceset e integritit në Bashkimin Evropian. Instituti KLGI synon të kontribuojë në vazhdimin e procesit të reformave në çështjet e qeverisjes lokale dhe të avancojë sistemin e decentralizuar të qeverisjes, me theks të veçantë në rritjen e llogaridhënies dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal.

Fokusi i KLGI-së është në konsolidimin demokratik dhe mirë-funksionimin e institucioneve të nivelit lokal lidhur me praktikën dhe trendet bashkëkohore. Në këtë perspektivë, KLGI-ja është aktive përmes hulumtimeve, avokimit, rrjeteve, këshillave për politika publike, ngritjen e kapaciteteve dhe forma të tjera të mbështetjes për qeverisjen lokale.

RRETH MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funkcionin e saj, MAPL-ja e ushtron në bazë të Kushtetutës, Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Përgjatë këtyre viteve, MAPL-ja ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL-ja ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

Misioni i Ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

HYRJE

Auditimi Social i zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Projektet e auditura nga grupi:

1. Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë – Ritender.
2. Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të eficientës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj.

Raporti paraqet metodologjinë e zbatuar nga Grupi i Auditimit Social, përfshirë:

- i. Mbledhjen e informacionit; sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave dhe krahasimet me modelet dhe standardet;
- ii. Monitorimin në terren; takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë);
- iii. Hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. Adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën.

Ky aktivitet është mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, që ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Instituti KLGJ, nëpërmjet Auditimit Social ka tri synime:

1. Rritjen e informacionit dhe njohurive për Auditimin Social;
2. Përfshirjen e qytetarëve në proceset publike lokale;
3. Ndërtimin e praktikave për angazhim të vazhdueshëm publik.

PROFILI I KOMUNËS

Kaçanik

Zona dhe Popullsia

Kaçaniku është qytet dhe komunë në jug të Kosovës. Me një sipërfaqe prej 211 kilometrash katrorë, duke përfshirë vetë qytetin dhe 31 fshatrat përreth. Ndërsa popullsia e komunës bazuar në regjistrimin e popullsisë 2024 është 27 716, banorë rezident.

Struktura Qeverisëse dhe Pasqyra Politike

Numri i përgjithshëm i votuesve në komunën e Kaçanikut të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në tetor 2021 ishte 32,647 duke përfshirë votuesit jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në votime ishte 49,8 për qind/15 902 votues (burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

Përbërja aktuale e Kuvendit Komunal:

1. Legjislativi

Kuvendi Komunal: **ulëse 27**

Rezultatet e zgjedhjeve:

PDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

43.84%

LVV – Lëvizja Vetëvendosje

30.43%

LDK – Partia Demokratike e Kosovës

16.28%

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

6.62%

NISMA – Aleanca Kosova e Re

2.83%

2. Ekzekutivi

Kryetari i Komunës: **Besim Ilazi (PDK)**

Drejtoritë e Komunës: **9**



TË ARDHURAT BUXHETORE

Kategoria	Vlera
a. Të hyrat vetanake	950,401
b. Granti i Përgjithshëm	5,538,386
c. Granti Specifik për Arsim	4,626,225
d. Granti Specifik për Shëndetësi	1,477,227
Totali	12,592,239

BUXHETI NË KATEGORI

Kategoria	Vlera
a. Pagat dhe shtesa	6,865,265
b. Mallra dhe shërbime	1,514,23
c. Shpenzimet komunale	225,000
d. Subvencionet dhe transferet	514,157
f. Investimet kapitale	3,473,583

Komuna e Kaçanikut ka:

Buxhet total: 12,592,239 Euro

Staf komunal: 822

KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL


Auditimi Social është njëri nga mjetet e informimit, përfshirjes dhe angazhimit qytetar në proceset komunale. Si dhe njëra nga metodat e kontributit konstruktiv të akterëve (qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit), në veçanti e përfituesve fundorë të investimeve komunale.

Ky proces synon të kontribuojë reciprokisht në dy dimensione: në njërën anë, të zgjerojë informacionin, njohuritë dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha stadet e zhvillimit të investimeve komunale (planifikim, zbatim, monitorim si dhe vlerësim) dhe në anën tjetër, të rrisë interesin e autoriteteve lokale për të forcuar pronësinë dhe kontributin direkt të qytetarëve në investimet komunale. Në fokus, për të rritur nivelin e performancës së komunave, në të gjitha stadet e investimeve kapitale nëpërmjet kontributit dhe monitorimit qytetar.

Auditimi Social është në frymën e parimeve të qeverisjes së mirë duke siguruar se autoritetet lokale, marrin parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat publike në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Si dhe duke siguruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social në komuna. Auditimi Social merr kuptim të plotë, atëherë kur publiku ka informacion, është i përfshirë dhe ka rol në proceset e politikave lokale. Përtej mjeteve dhe mekanizmave të zakonshëm, Auditimi Social, ka karakterin e bashkë-dizajnit dhe bashkë-krijimit të politikave lokale. Si hisedar, ai merr edhe rolin e monitoruesit dhe vlerësuesit të zbatimit dhe ndikimit real të investimeve komunale. Kështu, synimi parësor është të forcojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Instituti KLGJ, përgjatë këtij cikli të Auditimit Social, ka vendosur në fokus që pronësia e procesit të bartet tek organizatat dhe aktivistët lokalë, kjo duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të proceseve. E, njëkohësisht, që t'i ofrojë nivelit lokal metodologji, mjete dhe kapacitete, për të shtrirë Auditimin Social edhe në projektet tjera komunale.

Për të siguruar qasje sa më efektive në zbatim, Instituti KLGJ, është angazhuar në tri (3) dimensione: i. grupet e auditimit të reflektojnë gjithëpërfshirjen e qytetarëve; ii. njohja e vlerave dhe interesave të komunitetit lokal; iii. ndërthurja e dy të parave me proceset, praktikat dhe mekanizmat komunale.




PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), nëpërmjet auditimit social, informoi palët e interesit se do të monitorojë projektet kapitale të financuara nga Granti i Performancës në gjashtë komuna (Drenas, Viti, Skenderaj, Kaçanik, Ranillug dhe Shtime).

Takimi i parë - Themelimi i Grupit të Auditimit Social/Trajnimit

Fillimisht, me datë: **28 qershor 2024** u zhvillua takimi koordinues dhe trajnimi për gjashtë (6) organizatat partnere të përfshira në procesin e auditimit social. Ndërsa nëpërmjet letrës informuese, me datë: **7 korrik 2024**, është njoftuar komuna e Kaçanikut mbi projektet e përfshira dhe organizatën partnere lokale që do ta zbatojë Auditimin Social. Auditimi Social është zhvilluar në partneritet mes Institutit KLGJ dhe OMM Gjethi. Grupi i Auditimit Social në Kaçanik u themelua me datë: **15 gusht 2024**. Në takimin iniciues morën pjesë 15 qytetarë, prej tyre 12 burra dhe 3 gra. Grupi i Auditimit Social kishte përbërje diverse, duke përfshirë, dallime në moshë, profesion, përfaqësim dhe angazhime. Njëkohësisht, u zhvillua trajnimi mbi Auditimin Social i ndarë në tri sesione (njohja e legjislacionit mbi qeverisjen lokale; konceptet dhe metodologjia e auditimit social; shembujt dhe praktikat dhe analiza e kontratës).



Takimi i dytë/Analiza e kontratave dhe dokumenteve të projekteve.

Më datë: **16 tetor 2024** në Komunën e Kaçanikut, Grupi i Auditimit Social, mbajtën takimin e dytë për të analizuar kontratat dhe dokumentet e projekteve për auditim social: Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë dhe Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" – Elezaj. Takimi ishte një mundësi për të përforcuar bashkëpunimin mes qytetarëve, nga profesionet, mosha, gjini të ndryshme dhe për të siguruar gjithëpërfshirje në Grupin e Auditimit Social.

Gjatë analizimit të dokumenteve të projektit "Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë", sipas Grupit të Auditimit Social, ka për qëllim ofrimin e një hapësirë funksionale dhe rekreative për banorët, duke përmirësuar qasjen në hapësira publike dhe promovuar aktivitete sociale dhe kulturore. Ndërkaq, për projektin "Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU 'Nazmi Osmani' – Elezaj", u vlerësua se synimi kyç i investimit është në përmirësimin infrastrukturës shkollore dhe reduktimin e kostove energjetike.

Dokumentacioni, si kontratat, projektet, para-masat dhe parallogaritë ishin siguruar nëpërmjet qasjes në ueb faqe, e-prokurimit dhe komunikimit me Komunën e Kaçanikut. Gjatë takimit u morën parasysh obligimet kontraktuale që i ka komuna në implementimin e projekteve kapitale nga Granti i performancës. Po ashtu, ishte një praktikë e re, ku qytetarët pjesë e Grupit të Auditimit Social, diskutojnë mbi detajet e projekteve. Në takim prezent ishin rreth 13 qytetarë nga grupi i Auditimit Social.

Takimi i tretë/Vizita në Terren

Takimi i dytë është mbajtur më **18 dhjetor 2024**, ku pjesëmarrës nga grupi ishin 15 qytetarë. Fillimisht, u reflektua mbi metodologjinë, stadin e zbatimit të kontratës, analiza e përgjithshme, kriteret, parimet dhe standardet e investimit publik. Gjatë vizitave në terren u vlerësuan obligimet kontraktuale, afatet

kohore, si dhe dokumentacioni përcjellës, përfshirë edhe skicat vizuale. U ndanë rolet: mbajta e shënimeve, vrojtimet (mjedisi, pjesa inxhinierike, ndjeshmëria gjinore, grupeve të cenueshme, bizneset, ecuria e projektit); fotografimi i gjetjeve. Grupi i Auditimit Social në vizitën te projekti i Parkut afër Kalasë morën informacionet direkte nga punëkryesi lidhur me atë nëse ka pasur vonesa në nisjen e punimeve, përfshirë edhe pengesat nga operatorët tjerë si ata të energjisë, ujësjellësit, hekurudhave. Përderisa, gjatë vizitës te shkolla në Elezaj për vlerësimin e projektit Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efëciencës diskutuan me përfituesit, në këtë rast menaxhmentin e shkollës. Në të dyja projektet, u pa se a mund të përmirësohen, disa nga gjetjet në ato stade ku ishin punimet.

Takimi me komunën/adresimi, konfirmimi i gjetjeve dhe ndarja e rekomandimeve

Takimi i katërt me komunën është mbajtur me datë: **28 janar 2025**. Grupi i Auditimit Social në Kaçanik ka ndarë gjetjet dhe rekomandimet me nënkryetarin e Komunës dhe ekipin, për projektet e monitoruara. Ku u diskutuan gjetjet dhe u ndanë rekomandimet e projektit të përfshirë në këtë proces të monitorimit. Pas komenteve të komunës, janë reflektuar komentet në raportin final.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës **qershor 2024 - shkurt 2025**, Instituti KLGI me mbështetjen nga MAPL, ka zbatuar procesin e Auditimit Social në gjashtë (6) komuna, pjesë të financimit nga Granti i Performancës komunale, përfshirë edhe Kaçanikun.

Në Komunën e Kaçanikut kanë kaluar në procesin e Auditimit Social këto projekte:

1. **Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë – Ri tender.**
2. **Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj.**

Instituti KLGI ka përzgjedhur koordinatoren për komunën e Kaçanikut, duke e përfshirë në platformën www.klgi-platform.com, ku janë ndarë dhe zbatuar detyrat në këtë sekuencim: Koordinatorët, pas vlerësimit të shtrirjes gjeografike të projekteve si dhe strukturës së tyre, kanë identifikuar dhe përzgjedhur qytetarët (aktivistë, pjesë e shoqërisë civile, anëtarë të Këshillave Lokalë, profesionistë, përfaqësues apo direkt pjesëtarë të grupeve të nën-përfaqësuar dhe përfitues fundorë); Instituti KLGI dhe koordinatori, kanë përcaktuar dhe përgatitur takimin e parë/trajnimin, ku më pas është rivlerësuar për nevojën e zgjerimit të grupit pas analizimit fillestar të projektit si dhe kanë krijuar grupin e komunikimit elektronik; Koordinatorin dhe grupin kanë përcaktuar takimet e dyta/vizitat në terren, duke konsultuar përfituesit dhe marrë informacione rrethore nga bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë; Pas mbledhjes së informacioneve nga terreni, në takimin e tretë, janë hartuar gjetjet dhe nxjerrë rekomandimet; Në takimin me komunën janë adresuar gjetjet dhe janë paraqitur rekomandimet nga procesi i Auditimit Social.

Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë – Ri tender.

Grupi i Auditimit Social, gjatë monitorimit të projektit "Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë", vendosi tri fokuse: zbatimi i kontratës në terren; qasja gjithëpërfshirëse në shfrytëzim si dhe elementet estetike urbane. Sa i përket projektimit, u pa se një pjesë e konsiderueshme e parkut nuk ishte përfshirë në investim. Komuna paraprakisht, kishte kryer investimin e rrethojës së betonit, ndërkaq për pjesën e investimit, kjo kishte marrë kohë deri në definimin e pikave gjeodezike dhe komunikimeve me TRAINKOS. Në fillimin e punimeve, punëkryesi kishte pasur vonesa edhe në zhvendosjen e kioskave në atë pjesë. Por, që operatorët, si ai i rrjetit apo edhe ujësjellësit nuk kishin shkaktuar vonesa, e kjo i kishte mundësuar punëkryesit vendosjen e rrjetit nëntokësor.

Çështja e parë e ngritur nga Grupi i Auditimit Social, kishte të bënte me kapacitetin grumbullues të ujëmbledhësve. Ngase, ato ishin vendosur në disa pika, por që konfiguracioni i terrenit, mund të sjell grumbullim të ujit, në veçanti te muri ndarës me hekurudhën. Çështje tjetër me interes, kishte të bëjë me rregullimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara, nënave me karroca dhe të moshuarve. U pa, se qasja është rregulluar, por megjithatë shkallët paraprake, kanë mbetur ende të vendosura në një pjesë që parashihet për gjelbërim.

Një element, i rëndësishëm, kishte të bënte edhe me projektimin e ndriçimit për shtatorët, si dhe diskutim i rëndësishëm, ishte se a krijon parku qasje harmonike me shkollën ngjitur si dhe Kalanë. Sipas Grupit të Auditimit Social, konsiderohet e rëndësishme, që të sigurohet që të krijohet një lidhje harmonike mes parkut dhe objekteve, monumenteve përreth. Kjo edhe për faktin, se pjesa kryesore e saj, është e mbyllur/kufizuar nga hekurudha.

Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj

Përderisa, në projektin Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj, Grupi i Auditimit Social, vendosi fokusin në këto elemente: zbatimi i punimeve sipas kontratës,

standardet e efijencës nisur nga projektimi dhe zbatimi, si dhe shmangia e rrezikut nga ujërat (reshjet) dhe lidhja me sistemin e kullimit.

Grupi i Auditimit Social, pa se punimet ishin ende të papërfunduara, si pasojë kjo shkaktonte probleme me nisjen e vitit shkollor. Fillimisht, monitoruesit vendosën të shohin pjesën e kulmit, ku u pa se rrufepritësit janë vendosur, si dhe struktura e kulmit nuk vërehet ndonjë problem apo rrezik. Megjithatë, te vendosja e shkarkuesve (ulluqeve) u pa se ato nuk janë të lidhura me ujëmbledhësit, për pasojë ato rrezikojnë strukturën (objektin) si dhe nga ngrirja e bëjnë të papërdorshëm trotuarin. Një pjesë e hyrjes (anësoret e shkallëve), nuk ishin riparuar, edhe pse projekti kishte paraparë pjesën e izolimit. Pas kësaj, u vlerësua nëse izolimit i është vendosur mbajtësi metalik (shini) si dhe ajo e ndarjes së ujit (pikores). E para, rrezikon që brejtës të dëmtojnë izolimin, e dyta, rrezikon që ujë të rrjedhë në pjesën e themeleve.

Sa i përket vendosjes së dyerve të hyrjes, u pa se një pjesë e intervenimeve (vendosja e xhamave) ishte kryer joprofesionalisht, përfshirë vendosjen e izoluesit (salikonit) dhe mbajtëseve (shinave) në dyer. Edhe pse në kontratë ishin paraparë, vendosja e dyerve me tre shirita (dihtuna) izolues, aty u panë vetëm nga dy. Po ashtu, riparimet e parapara të mureve, ende nuk ishin përfunduar.

**Detajet janë të paraqitura në pjesën e gjetjeve, rekomandimeve dhe komenteve të komunës.*

HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Procesi i auditimit social, referohet në metodologjinë e punës përfshirë:

- i. **Mbledhja e informacionit** – sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me kriteret, parimet dhe standardet;
- ii. **Vizitat/monitorimin në terren** – takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë) dhe komentet e anëtarëve të grupit;
- iii. **Puna e grupit të Auditimit Social** – hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. **Takimi në komunë** – adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën dhe ndarja e rekomandimeve.

METODOLOGJIA

Përzgjedhja e Projekteve, Komunave dhe Grupit të Auditimit

Instituti KLGI, referuar **Aneksit I**, të kontratës (KLGI – MAPL) duke marrë listën e projekteve të bashkëfinancuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunitet në kuadrin e Grantit të Performancës Komunale. Ky rregull ka vlejtur në gjashtë (6) komuna (*Drenas, Viti, Skënderaj, Kaçanik, Ranillug dhe Shtime*).

Komunitet ku është kryer Auditimi Social, ofrojnë një pasqyrim të kontekstit të përgjithshëm lokal duke pasur parasysh, se përfshihen, komuna të mëdha, të vogla, komuna kufitare, me shtrirje të madhe dhe të vogël gjeografike, me përfaqësim të ndryshëm të komuniteteve etnike.

Instituti KLGI, procesin e përzgjedhjes së grupeve të Auditimit Social e ka shtrirë në tri nivele dhe dimensione: i. përzgjedhja e një OJQ-je lokale të angazhuar në komunitetin lokal; ii. gjithëpërfshirja (diversiteti) brenda grupit të Auditimit Social dhe iii. zgjerimi i grupit të Auditimit Social, sipas kontekstit dhe strukturës së projekteve të monitoruara (parqe, rrugë, terrene sportive, investime në ambient), duke siguruar edhe përfshirjen e përfituesve të fundit.

Fokusi Grupit të Auditimit Social në Kaçanik

Në projektin Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit – Ritender fokusi i Auditimit është shtrirë në: zbatimin e kontratës, përfshirë edhe standardet dhe parametrat në ndërtimin e parkut, ndjeshmëria e grupeve të cënueshme, janë trajtuar qasja për personat me aftësi të kufizuara.

Ndërkaq, në projektin Izolimi i jashtëm dhe zbatimin e masave të efikasitetit në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj, fokusi ka qenë në këto aspekte: shqyrtimi i dokumentacionit, zbatimin e kontratës; implementimi i aktiviteteve të projektit; ecuria e punëve; cilësia e punëve në terren; si dhe standardet e përdorura.

Indikatorët e performancës të përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektin e monitoruar janë:

1. A ndoqi zbatimin një plan të qartë veprimi?
2. A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit?
3. A janë publikuar me kohë dokumente të projektit në web faqen e komunës dhe e-prokurimi?
4. Cilat ishin arsyet e vonësës?
5. Si është realizuar buxheti në relacion me planin?
6. Cilat janë rekomandimet për të përmirësuar më tej projektin/?
7. A ka ndonjë ankesë të veçantë në lidhje me projektin/shërbimin në fjalë?

Përtej indikatorëve të vlerësimit të zbatimit, monitoruesit kanë nxjerrë të dhëna edhe për ndikimin në mjedis dhe sigurinë e nxënësve:

1. A ndikon projekti/shërbimi në degradimin e ambientit?
2. A ka pasur pengesa në procesin e mësimit gjatë implementimit të projektit.

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Komunën e Kaçanikut:

- Projektet me detaje janë siguruar nga Komuna;
- Kontratat me detaje janë gjetur në web faqen e komunës dhe në web faqen e Prokurimit Publik të Kosovës e -prokurimi.

Grupi i Auditimit Social në takim me komunën ka adresuar këto pyetje?

Izolimi i jashtëm dhe zbatimin e masave të efikasitetit në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj

- A ka pasur konsultime me qytetarët dhe grupet e interesit para fillimit të projektit?
- A janë respektuar afatet kohore?
- A janë implementuar të gjitha aktivitetet e parapara në kontratë?
- Cilat standarde janë përdorur në projektimin e masave të efikasitetit?

Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit – Ritender

- A ka pasur konsultime qytetarët dhe grupet e interesit para projektimit të ndërtimit të parkut?
- Kur do të përfundojë ndërtimi i parkut?
- Kur planifikohet të përfundohet faza tjetër (te lodrat e fëmijëve)?

RRETH PROJEKTEVE

Projekti	Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj. Numri i prokurimit: 652-24-4481-5-2-1
Çmimi total i punëve në kontratë	77,777.77 €
Statusi i kontratës	E përfunduar

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Kaçanikut

Zbatues: Operatori Ekonomik OE – ENGINEERING RK SH.P.K.

Rikapitulim i Përgjithshëm		
Nr.	Kategoritë	Shuma
1	Punët e arkitekturës	870.00 €
2	Dritaret	40,765.00 €
3	Dyert	6,310.00 €
4	Fasada e jashtme e ndërtesës	27,289.40 €
5	Ulluqet	2,543.4 €
	Totali	77,777.77 €

Projekti	Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit – Ritender Numri i prokurimit: 652-24-8148-5-2-1
Çmimi total i punëve në kontratë	139,155.03 €
Statusi i kontratës	Në zbatim

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Kaçanikut

Zbatues: Operatori Ekonomik "PLUS TRADE" L.L.C & N.N.P"ATC COM"

Rikapitulim i Përgjithshëm		
Nr.	Kategoritë	Shuma
1	Punët përgatitore	2,400.00 €
2	Punët e dheut	28,282.80 €
3	Punët e kubëzave, anësoret, elementet vinkëll	33,122.25 €
4	Betoni dhe armatura	22,642.00 €
5	Drenazhimi	9,755.00 €
6	Ndriçimi	15,048.00 €
7	Punët e parkut dhe këndit të lojërave	9,537.10 €
8	Punët e mbishkrimit "Kaçanik"	8,520.55 €
9	Punët e fontanës	899.72 €
10	Sistemi i ujitjes	8,947.00 €
	Totali	139,155.03 €

GJETJET KRYESORE

Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në shkollë në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj dhe Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë. Si konstatim i përgjithshëm, vlen të theksohet se: këto projekte, kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin dhe zgjerimin hapësirave publike dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Megjithatë, evidentohen disa mangësi: lidhja e parkut (qasja harmonike) me hapësirat tjera si shkolla dhe pjesa e qytetit; disa punime kërkojnë vëmendje të shtuar, përfshirë ato të kullimit, shkallëve si dhe rrjetit elektrik. Ndërkaq, për projektin zbatimi i masave të efijencës në shkollë, nuk ka vendosur një projektion më afatgjatë, duke mos vendosur mbajtëse (potenciale) për solar, apo edhe disa mangësi në përdorimin e materialeve të efijencës. Problemi më serioz ka të bëjë me moslargimin e ujit nga kulmi nga struktura e objektit (në rrjetin e kullimit).

Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në ShMU "Nazmi Osmani" Elezaj



e zbatimit.

Në hyrje të investimit (objektit) nuk është vendosur tabela për projektin me detajet e investuesit, shuma dhe periudha



Referuar kontratës, tek (punët e arkitekturës), nuk është evidentuar ndonjë plan detaj apo edhe skicë vizuale për zbatim.



Në kontratë, parashihet rregullimi, suvatimi rreth dyerve dhe dritareve. Nga monitorimi, vërehet se në pjesën e hyrjes së objektit, nuk është suvatuar (riparuar) muri pas vendosjes së tyre. Ku janë të dukshme rrjetat e suvatimit të vrazhdë.



Po ashtu, sa i përket pozicionit dyert dhe dritaret. Në paramasa është planifikuar vendosja e tre

(3) izoluesve (diktunëve), por evidentohen vetëm dy (2) izolues.



Pika me sfiduese, mbetet vendosja (lidhja) e ulluqeve me rrjetin kullues. Për pasojë, pjesa më e madhe e tyre nuk i kanë të vendosur as kthesat për largimin e ujit nga objekti. Për rrjedhojë, kjo mund të dëmtojë investimin, e njëkohësisht të rrezikojë nxënësit përgjatë lëvizjes (rrëshqitjes) nga ngrirja e ujit.



Sa i përket izolimit, në vrojtim del se nuk janë të vendosura pikoret dhe as shiritat (shinat) mbajtës të stiriporit. Për rrjedhojë, mund të dëmtohet izoluesi (stiropori) dhe uji rrezikon të rrjedhë përgjatë strukturës (murit) pa u larguar.

Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit – Ritender

Projekti ka pasur një rrjedhë konsiderueshëm të mirë. Si dhe punëkryesit kanë ofruar informacione të vlefshme për punimet dhe zbatimin e kontratës.



Vlerësohet se përkundër se është planifikuar në para-masa dhe para-llogari vendosja e kulluesve, parë nga hapësira e madhe e grumbullimit, konsiderohet se vendosja vetëm në disa pozicione nuk do të jetë e mjaftueshme. E, kjo mund të çojë në grumbullim të muri mbrojtës (me hekurudhën).



Në punimet e zhvendosjes (së tavolinave dhe ulëseve) vlerësohet se evidentohen mangësi. Megjithatë, punëkryesi ka marrë përsipër riparimin dhe rivendosjen e tyre. Kjo ka ndodhur edhe me disa dëmtime të shkaktuara në drunjtë në atë pjesë. Edhe pse ata janë hequr, konsiderohet se rigjenerimi i tyre ka probleme.

Përtej Projekteve:

Te projekti i parakut, vlerësohet se projektimi për shkak të kufizimeve nga hapësira e hekurudhës, nuk ka mundur një qasje të integruar. Por, kjo duhet shqyrtuar në pjesën e mbetur të lidhet me pjesën e rrugës dhe objektin shkollor.



Në vendosjen e ndriçimit, nuk është planifikuar vendosja e ndriçuesve për shtatoren. Nga komunikimi, punëkryesi ka vullnet që kjo të shtohet.



Konsiderohet i rëndësishëm investimi në shkallët dhe hapësirat e shkollës afër parkut. Por, që kërkohet angazhim shtesë në lidhjen (harmonike) mes dy projekteve.



Në zbatimin e punimeve, evidentohet se pjesa e rrjetit nëntokësor (gypave të ujit, drenazhimit dhe elektike) ka përfunduar. Kjo konsiderohet se ka zgjidhur problemet për ndërhyrje pas investimit.



Një pjesë e shkallëve nga struktura paraprake e parkut ka mbetur edhe pse projekti ka paraparë qasje direkte pa shkallë në park. Kjo, vlerësohet si qasje e panevojshme dhe kufizim i hapësirës gjelbëruese.

REKOMANDIMET

Rregullimi i sistemit të kullimit:

- Duhet të rregullohet dhe përmirësohet sistemi i kullimit, duke siguruar që të lidhen kulluesit (ulluqet) vertikale me ujëmbledhësit në të gjitha shkollat për të parandaluar mundësinë e dëmtimeve nga rrjedhja e ujit. Po ashtu, të planifikohet vendosja e grumbulluesve të ujit në mënyrë që të shfrytëzohen për mirëmbajtjen e hapësirave (oborrit).

Riparimi i punimeve të mbetura:

- Pjesët e rregulluara të murit duhet të riparohen dhe të suvatohen saktësisht, veçanërisht pas vendosjes së dritareve dhe dyerve. Gjithashtu, duhet të kontrollohet dhe përmirësohet vendosja e izoluesve në përputhje me projektin për të siguruar efektivitetin termik.

Përmirësimi i ndriçimit të parkut dhe shtatores:

- Ndriçimi i shtatores duhet të parashikohet dhe të realizohet si pjesë e planifikimit për ndriçimin e parkut.
- Duhet të përkushtohet vëmendje e veçantë për rigjenerimin e drurëve të dëmtuar dhe mbjelljen e bimëve të reja për të siguruar që parku të mbetet një hapësirë e gjelbër e këndshme për publikun.

Përtej Projekteve:

Përmirësimi i efikasitetit energjetik në shkollë:

- Në projektin e shkollës, duhet të përfshiheshin mbajtës potencialë për panele diellore për të mundësuar një burim të qëndrueshëm energjie në të ardhmen. Materialet që përdoren për izolim dhe efikasitet duhet të jenë të certifikuara dhe të përputhura me standardet për të siguruar një performancë optimale dhe jetëgjatësi të strukturës.

Promovimi i investimeve nga Granti i Performances:

- Duhet të vendoset një tabelë informacioni në hyrje të objektit për të mundësuar transparencë në lidhje me investitorin, shumën dhe periudhën e realizimit të projektit.

Lidhja harmonike mes parkut, shkollës dhe kalasë:

- Duhet një qasje më harmonike mes parkut dhe hapësirave përreth, përfshirë lidhjen me shkollën dhe pjesët e tjera të qytetit. Kjo mund të arrihet përmes projektimit të shtuar të rrugëve dhe kalimeve.

Evitimi i grumbullimit të ujërave atmosferikë në park:

- Përkundër se punimet kanë përfunduar sipas projektit, para masave dhe para llogarive, sa i përket ujëmbledhësve konsiderohet se mund të ketë grumbullim në disa pjesë.

KOMENTET E KOMUNËS

Komentet e përgjithshme

Në takimin me Nënkryetarin dhe ekipin e komunës, fokusi i diskutimit u vendos në këto elemente: përmirësimi i projektimit në fokus masat e efijencës, konsultimi me palët e interesit dhe organizatat profesionale si dhe evidentimi i shmangies së rreziqeve nga ujërat në investimet kapitale. Komuna e Kaçanikut, paraqet një model të angazhimit të organizatave në bashkë-dizajnimin e projekteve, në veçanti ato që lidhen me mjedisin, si dhe kontributin gjithëpërfshirës në projektet investuese komunale.

Komentet Specifike:

- **Rekomandimi:** Rregullimi i sistemit të kullimit
 - **Komenti i Komunës:** Riparimi i kulmit në fshatin Elezaj, si dhe vendosja e shkarkuesve (ulluqeve) në rrjetin e kullimit, konsiderohet se ka qenë e pamundur, ngase nuk ka rrjet kullimi. Ka ekzistuar një propozim, që kjo të bëhet duke i zhvendosur (larguar) ujërat, por që duhet prodhuar një zgjidhje e qëndrueshme, duke mos përjashtuar edhe përdorimin për ujitje.
- **Rekomandimi:** Riparimi i punimeve të mbetura
 - **Komenti i Komunës:** Në investimet në masat izoluese, komuna ende nuk ka kryer pranimin teknik. Komuna, ka evidentuar disa nga problemet deri në finalizim, pret nga kompania që t'i kryej, suvatimet riparimet rreth dritareve dhe dyerve, si dhe vendosjen e izoluesit në dritare.
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i ndriçimit të parkut dhe shtatores
 - **Komenti i Komunës:** Komuna dhe kompania punëkryese e konsiderojnë të vlefshme gjetjen, ngase rrjeti energjetik është kryer në atë pjese, të vendoset një dalje (kyçje) për ndriçim të shtatoreve.

Përtej Projekteve:

- **Rekomandimi:** Përmirësimi i efikasitetit energjetik në shkolla
 - **Komenti i Komunës:** Komuna vlerëson se në projektet të ardhme, së paku të planifikohen vendosja e mbajtësve si dhe sistemit përcjellës për vendosjen e paneleve solar. Komuna ka planifikuar vendosjen e tyre në 13 objekte dhe ndërtesa, përfshirë shkollat.
- **Rekomandimi:** Promovimi i investimeve nga Granti i Performancës (i përgjithshëm);
 - **Komenti i Komunës:** Komuna, merr në konsideratë rekomandimin edhe pse vlerëson se ka marrë disa veprime, përfshirë prezantimin e projekteve të financuara nga Granti i Performancës. Megjithatë, konsideron se me organizatat si Gjethi, si dhe përfituesit mund të rriten inkurajimi i qytetarëve për të përmirësuar edhe më shumë kontributin qytetar në rritjen e treguesve të performancës.
- **Rekomandimi:** Lidhja harmonike mes parkut, shkollës dhe kalasë
 - **Komenti i Komunës:** Komuna gjatë projektimit ka pasur disa kufizime, në veçanti sa i përket pjesës që lidhë me hekurudhën. Për të shmangur rrezikun dhe zhurmën është ndërtuar muri mbrojtës, kjo edhe ka shtyrë punimet deri te vendosja e pikave. Komuna, vlerëson se në partneritet me organizatat dhe grupet tjera, duke përdorur masa të estetikës urbane të krijojë një lidhje harmonike mes këtyre hapësirave.
- **Rekomandimi:** Evitimi i grumbullimit të ujërave atmosferikë në park
 - **Komenti i Komunës:** Rruga ngjitur ka një rrjet efikas të grumbullimit, e po ashtu edhe në park janë të planifikuara disa ujëmbledhës. Në rast se dalin probleme, komuna mund të shqyrtojë rekomandimin për vendosjen e një sistemi kullimi në krejt pozicionin (rrjete kulluese).

LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	VALON RAKA	Koordinator i grupit/OMM Gjethi
2	REMZI REKA	OMM GJETHI
3	SAMI STAGOVA	OMM GJETHI – Arkitekt/planifikues urban
4	THOMAS WEIS	Peace Corps – OMM Gjethi/Ekonomist
5	EMRIN DEMA	KRYQI I KUQ I KOSOVËS/Aktivist
6	SALIH RUNJEVA	Agronom/Bankier
7	BRENDA WEIS	Peace Corps/English Teacher/Profesor
8	SHEFKI GURI	Drejtor i Gjimnazit “Skënderbeu”/Fizikant
9	ATDHE NEZIRI	Drejtor i Shkollës profesionale/Inxh elektrik
10	VALON TERZIU	Përfaqësues i fsh. Elezaj
11	YBER SHEHU	Shef i stacionit të zjarrfikësve Kaçanik
12	REMZI CAKA	Ish drejtor / Pensionist
13	KASTRIOT SHEHU	Biznesmen/Ndërmarrës
14	ZIJADIN OSMANI	Drejtor i ShMU “Nazmi Osmani” Elezaj
15	MUHAMET REKA	Kurbetçar nga diaspora

